<p>3. Në kuptim të këtij neni, nuk konsiderohet person i tatueshëm çdo organizatë jo- fitimprurëse për pagesa të përfituara nga anëtarësia, nëse kanë të tilla ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jo- fitimprurëse të organizatës, në përputhje me Ligjin përkatës për organizatat jo- fitimprurëse, përveç kur kjo organizatë përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike.</p>	<p>3. Pursuant to this article, any non-profit organisation for payments deriving from membership, if they have such or funds, grants, donations received for the purpose of their non-profit activity shall not be considered a taxable person, in accordance with relevant Law on non-profit organisations, unless the organisation receives payments as a result of an economic activity.</p>	<p>3. Po ovom članu, ne smatra se poreski obveznik svaka neprofitne organizacija koja ima koristi od članarine, ili ako imaju takve fondove, grantove, dobijene donacije za neprofitne za ciljeve aktivnosti organizacije, u skladu sa relevantnim zakonom o neprofitnim organizacijama, osim kada ova organizacija dobija isplate kao rezultat privredne aktivnosti.</p>
<p>4. Organet e organizatave ndërkombëtare, shtetet e huaja dhe agjencitë e tyre nuk duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose</p>	<p>4. Bodies of International organisations, foreign countries and their agencies shall not be regarded as taxable persons in respect of the activities or transactions</p>	<p>4. Organi međunarodnih organizacija, stranih država i njihove agencije ne treba smatrati kao oporeziva lica u vezi sa aktivnostima ili transakcijama istim ili</p>

<p>transaksionet e ngjashme, apo identike me ato të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni edhe nëse ato pranojnë pagesa në lidhje me ato aktivitete. Mirëpo, agjencitë e shteteve të huaja duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me ato aktivitete ose transaksione kur trajtimi i tyre në shtetin e tyre mund të shpinte në konsiderimin e këtyre aktiviteteve sikur janë zhvilluar nga personi i tatueshëm.</p>	<p>similar or identical to those mentioned in paragraph 1 of this Article, even if they receive payments regarding those activities. However, agencies of foreign countries shall be regarded as taxable persons in respect of those activities or transactions where their treatment in their own country would result in considering those activities as being carried out by a taxable person.</p>	<p>sličnim onima iz stava 1. ovog člana, čak i ako dobiju isplate u vezi sa tim aktivnostima. Međutim, agencije stranih zemalja će se smatrati kao oporeziva lica u vezi sa tim aktivnostima ili transakcijama u kojima bi ih njihov tretman u svojoj zemlji dovo do razmatranja ovih aktivnosti kao da su sprovedene od strane poreskog obveznika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Autoritetet Publike</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Public Authorities</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Javni vlasti</p>
<p>1. Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal dhe organet tjera të rregulluara me ligj, nuk duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet, në të cilat angazhohen si autoritete publike edhe atëherë kur mbledhin tagra, taksa, kontribute ose pagesa në lidhje me ato aktivitete ose me ato transaksione.</p>	<p>1. Authorities of central and local level and other bodies regulated by Law shall not be regarded as taxable persons in respect of the activities or transactions in which they engage as public authorities, even where they collect duties, fees, contributions or payments regarding those activities or transactions.</p>	<p>1. Vlasti centralnog i lokalnog nivoa i druga tela koja su zakonom regulisana neće se smatrati poreskim obveznicima u vezi sa aktivnostima ili transakcijama u kojima su angazovani kao javne vlasti i kada prikupljaju takse, porezi, doprinoie ili isplate u vezi sa tim aktivnostima ili tim transakcijama.</p>
<p>2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, nw rastet kur:</p>	<p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, in cases when:</p>	<p>2. Isključivo iz stava 1 ovog člana, kada:</p>
<p>2.1. autoritetet e nivelit qendror dhe lokal angazhohen në aktivitetet e listuara në Shtojcën I të këtij ligji, do të konsiderohen persona të tatueshëm me kusht që aktivitetet e tilla nuk</p>	<p>2.1. Authorities of central and local level are engaged in listed activities in Annex 1 of this Law, will be considered taxable persons with condition that such</p>	<p>2.1. se vlasti centralnog i lokalnog nivoa angazuju u aktivnostima navedenim u Aneksu i ovog Zakona, oni se smatraju oporezive osobe pod uslovom da se</p>

<p>zhvillohen në atë shkallë të vogël sa që të jenë të neglizhueshme;</p> <p>2.2 autoritetet e nivelit qendror dhe lokal të cilat angazhohen në aktivitete dhe transaksionet, do të konsiderohen persona të tatueshëm atëherë kur trajtimi i tyre si persona të pa-tatueshëm do të çojë në dëmtim të theksuar të konkurrencës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Dispozitat e përgjithshme lidhur me kërkesën për t'u regjistruar dhe për të lëshuar Certifikatën e regjistrimit</p> <p>1.Çdo person që i përmbush të gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm të referuar në nenin 4 të këtij ligji, kërkohet që të regjistrohet për TVSH, nëse brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30,000€). Vetëm pjesa e furnizimit e cila rezulton në tejkalimin e qarkullimit, merret parasysh për qëllime të TVSH-së.</p> <p>2. Procedura për regjistrim, forma, përmbajtja dhe kushtet e përdorimit të certifikatës së TVSH, rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>activities aren't conducted in small scale as to be neglected;</p> <p>2.2 Authorities of local and central level which are engaged in activities and transactions, will be considered as taxable persons when their treatment as taxable persons will lead to emphasized harm of competition.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 General provisions as regards requirement to be registered and to issue the Registration Certificate</p> <p>1.Any person who meets all conditions of the definition for taxable person referred to Article 4 of this Law is required to register for VAT if it, exceeds the turnover of thirty thousand (30,000€) within each calendar year. Solely the portion of the supply which results in exceeding the turnover shall be taken into account for VAT purposes.</p> <p>2. The procedure for registration, form, content and terms of use of the VAT certificate are regulated by sub-legal act issued by the Minister.</p>	<p>takve aktivnosti ne sprovode do takvog stepena koji su zanemarljivi;</p> <p>2. 2 vlast centralnog i lokalnog nivoa koji se bave aktivnostima i transakcijama smatraju se oporezivim licima kada njihovo tretiranje kao neoporeziva lica dovede do značajne štete konkurencije.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Opšte odredbe u vezi zahteva za registraciju i izdavanje certifikata o registraciji</p> <p>1. Svako lice koje ispunjava sve uslove definicije oporezive osobe iz člana 4. ovog Zakona dužni su da se registruje za PDV, ako u kalendarskoj godini prelazi promet od trideset hiljada evra (30.000 €). Samo deo snabdevanja koji dovodi do prekoračenja prometa uzima se u obzir za potrebe PDV-a.</p> <p>2. Postupak registracije, oblik, sadržaj i uslovi korišćenja certifikata za PDV uređuju se podzakonskim aktom koji donosi ministar.</p>
--	--	--

<p>3. Personi fizik që zhvillon aktivitet ekonomik të njëjtë apo të ndryshëm dhe ka disa vende të aktivitetit ekonomik brenda Kosovës, për qëllime të këtij ligji, duhet të identifikohet përmes një numri individual dhe unik të regjistrimit për TVSH. Kur një person fizik regjistrohet për qëllime të TVSH-së me një numër personal të identifikimit, Administrata duhet t'i lëshoj një certifikatë të regjistrimit sikur që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.</p>	<p>3. A natural person conducting the same or different economic activities and who has several places of economic activity within Kosovo, shall be identified by one individual and unique VAT registration number for the purposes of this Law. When a natural person is registered for VAT purposes under his/her personal identification number, the administration shall issue one registration certificate to such person as foreseen by paragraph 2 of this Article.</p>	<p>3. Fizičko lice koje ima istu ili različitu privrednu aktivnost i ima više mesta privredne aktivnosti na Kosovu, u smislu ovog Zakona, identifikuje se putem pojedinačnog i jedinstvenog registracionog broja za PDV. Kada se fizičko lice registruje za ciljeve PDV-a sa ličnim identifikacionim brojem, Administracija će izdati certifikat o registraciji kako je definisano u stavu 2. ovog člana.</p>
<p>4. Ortakëria dhe grupimi i personave, për qëllime të këtij ligji, duhet të identifikohet me një numër të vetëm të regjistrimit për TVSH. Për përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj, ortakët ose anëtarët e grupit të personave duhet të caktojnë një ortak të përgjithshëm, përfaqësues respektivisht anëtar përfaqësues. Kur ortakët ose anëtarët nuk janë ende të regjistruar për qëllime të TVSH-së, ata mund të zgjedhin për t'u regjistruar për këtë qëllim para regjistrimit të ortakërisë apo grupimit të personave.</p>	<p>4. A partnership and grouping of persons shall be identified by one single VAT registration number for the purposes of this Law. Partners or members of the persons' grouping shall appoint a general partner, respectively a member-representative to fulfil the obligations and exercise the rights defined by this Law. When the partners and members are not registered for VAT purposes yet, they may choose to be registered for these purposes prior to the registration of the partnership or grouping of persons.</p>	<p>4. Partnerstvo i grupisanje lica u smislu ovog Zakona treba identifikovati jedinstvenim registracionim brojem PDV-a. Za ispunjavanje obaveza i ostvarivanje prava utvrđenih ovim zakonom, partneri ili članovi grupe lica, imenuju generalnog partnera, predstavnika ili člana predstavnika. Kada partneri ili članovi još nisu registrovani u cilju PDV-a, oni se mogu odlučiti da se registruju za to pre registracije partnerstva ili grupisanja lica.</p>
<p>5. Personat të cilët nuk janë të vendosur në Kosovë, i nënshtrohen regjistrimit të TVSH-së nga fillimi i zhvillimit të aktivitetit ekonomik në Kosovë. Personat e</p>	<p>5. The persons not established in Kosovo are subject to VAT registration, from the beginning of their economic activity in Kosovo. Such taxable persons not</p>	<p>5. Lica koja ne borave na Kosovu podležu registraciji PDV-a od početka razvoja privrednih aktivnosti na Kosovu. Takva oporeziva lica koja ne borave ili nisu</p>

<p>tillë të tatueshëm që nuk janë të vendosur në Kosovë, duhet ta emërojnë një përfaqësues tatimor ashtu siç është referuar në paragrafin 5 të nenit 52 të këtij ligji. Personi i tatueshëm ë regjistrohet me emrin e tij dhe në emrin e përfaqësuesit të tij tatimor brenda pesë (5) ditëve pas emërimit si përfaqësues tatimor dhe para fillimit të aktivitetit ekonomik në Kosovë. Megjithatë, ata nuk janë të obliguar të regjistrohen, në qoftë se ata kryejnë vetëm furnizime ndaj pranuesit, i cili është i obliguar të paguajë TVSH-në sipas nenit 52 nën-paragrafit 1.2. dhe 1.3. të këtij ligji, mirëpo, akoma konsiderohen persona të tatueshëm.</p>	<p>established in Kosovo shall appoint a tax representative as referred to in paragraph 5 of Article 52 of this Law. The taxable person shall be registered under his own name and the name of his tax representative within five (5) days after the appointment as tax representative and prior to the beginning of economic activity in Kosovo. However, they are not obliged to be registered, if they carry out only the supply to the recipient that is obliged to pay VAT according to Article 52 subparagraph 1.2 and 1.3 of this Law, however they shall still be considered as taxable persons.</p>	<p>smeštteni na Kosovu trebala bi imenovati poreskog zastupnika iz stava 5 člana 52 ovog Zakona. Oporezivo lice se registruje sa svojim imenom i na ime svog poreskog zastupnika u roku od pet (5) dana nakon imenovanja kao poreskog zastupnika i pre početka privredne aktivnosti na Kosovu. Međutim, nisu u obavezi da se registruju ako vrše snabdevanja samo za primaoca koji je dužan da plati PDV po članu 52. podstav 1.2. i 1.3. ovog Zakona, ali, i dalje se smatraju oporezivim licima.</p>
<p>6. Administrata trajton sikur të ketë qenë i regjistruar për qëllimet e TVSH-së, çdo person që vazhdon të zhvillojë aktivitet ekonomik të personit të tatueshëm i cili ka vdekur, bankrotuar apo nuk është në gjendje të zhvillojë aktivitet ekonomik, nga data në të cilën personi i tatueshëm ka vdekur, bankrotuar apo nuk është në gjendje të zhvillojë aktivitet ekonomik, derisa personi tjetër të regjistrohet.</p>	<p>6. The Administration shall treat any person carrying out an economic activity of a taxable person who dies or becomes bankrupt or is not capable to develop an economic activity as if he were registered for VAT purposes from the date when the taxable person died or became bankrupt or incapacitated until the other person is registered.</p>	<p>6. Administracija tretira sve kao da su registrovani u cvilju PDV-a, svako lice koje nastavlja da ima privrednu aktivnost poreskog obveznika koji je umro, bankrotirao ili nije u stanju da razvija privredne aktivnosti od datuma na koji je oporezivo lice umrlo, bankrotirao ili nije u stanju da obavlja privrednu aktivnost dok se drugo lice ne registruje.</p>
<p>7. Personat e huaj që zhvillojnë aktivitet ekonomik në Kosovë, konsiderohen persona të tatueshëm që nga fillimi i</p>	<p>7. Foreign persons developing an economic activity in Kosovo shall be, considered taxable persons since the</p>	<p>7. Stranac, koji se bavi privrednom aktivnošću na Kosovu smatra se oporezivim licem od početka privredne aktivnosti na Kosovu.</p>

<p>ushtrimit të aktivitetit ekonomik në Kosovë.</p> <p>8. Njësia e përhershme e personit jo rezident është person i tatueshëm që nga fillimi i aktivitetit ekonomik në Kosovë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Regjistrimi i obligueshëm – obligimi për të komunikuar ndryshimet e të dhënave të regjistrimit</p> <p>1. Çdo person, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj, është i obliguar që të regjistrohet për TVSH nga momenti i kalimit të qarkullimit që është referuar në paragrafin 1, të nenit 6 të këtij ligji dhe duhet të njoftojë Administratën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim. Regjistrimi hyn në fuqi në datën kur tejkalohej qarkullimi.</p> <p>2. Çdo person, i cili nuk e ka bërë njoftimin dhe regjistrimin me kohë, duhet të regjistrohet në mënyrë të detyrueshme nga Administrata me efekt retroaktiv qysh nga data e tejkalimit të pragut, sikur që është përkufizuar në paragrafin 1, të nenit 6 të këtij ligji.</p>	<p>commencement of exercising an economic activity in Kosovo.</p> <p>8. The permanent unit of non-resident person shall be the taxable person since the commencement of the economic activity in Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Compulsory Registration – an obligation to communicate changes in registration data</p> <p>1. Any person, unless otherwise provided in this Law, shall be obliged to register for VAT upon the event of reaching a turnover referred to paragraph 1 of Article 6 of this Law and shall notify the the administration within fifteen (15) calendar days from the moment the obligation for registration is born. The registration is effective on the date when the turnover is exceeded.</p> <p>2. Any person, who fails to notify and register in due time, is subject to compulsory registration by the Administration with retroactive effect from the date of exceeding the threshold as defined in paragraph 1 of Article 6 of this Law.</p>	<p>8. Stalna jedinica nerezidentog lica je oporezivo lice od početka privredne aktivnosti na Kosovu.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Obavezna registracija - obaveza saopštavanja promene podataka registracije</p> <p>1. Svako lice, osim ako je drugačije propisano ovim zakonom, dužno je da se registruje za PDV od trenutka prenosa prometa iz stava 1 člana 6 ovog Zakona i obaveštava Administraciju u roku od petnaest (15) kalendarskih dana, od trenutka kada je nastala obaveza registracije. Registracija stupa na snagu danom prekoračenja prometa.</p> <p>2. Svako lice koje nije obavilo saopštanje i prijavu na vreme, treba da se obavezno registruje od strane Administracije sa retroaktivnim dejstvom od datuma prekoračenja praga kako je definisano u stavu 1 člana 6 ovog Zakona.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 8 Regjistrimi vullnetar</p> <p>1. Çdo person që i plotëson kushtet e referuara në nenit 4 të këtij ligji, por që nuk i plotëson kërkesat për regjistrim të referuara në nenin 6 të këtij ligji, e ka të drejtën që të zgjedhë për t'u regjistruar dhe për këtë duhet të njoftojë Administratën.</p> <p>2. Administrata regjistron personin e tillë me efekt nga data e pranimit të kërkesës, nëse personi i cili ka parashtruar kërkesën plotëson kushtet e nenit 4 të këtij ligji.</p> <p>3. Tatimpaguesit e regjistruar vullnetarisht i nënshtrohen rregullave të njëjta në lidhje me ndryshimin dhe pushimin e aktivitetit sikurse personat e tatueshëm, të regjistruar në pajtueshmëri me nenin 6 të këtij ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Voluntary Registration</p> <p>1. Any person meeting the conditions referred to in Article 4 of this Law, but not meeting the registration requirements referred to in Article 6 of this Law, shall have the right to choose to be registered and shall notify the administration accordingly.</p> <p>2. The Administration shall register such person effectively from the date of receiving the request if a person making the request meets the conditions of Article 4 of this Law.</p> <p>3. Voluntary registered taxpayers are subject to the same rules in respect of changing and cessation of activity as other registered taxable persons in accordance with Article 6 of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Dobrovoljna registracija</p> <p>1. Svako lice koje ispunjava uslove iz člana 4. ovog Zakona, ali ne ispunjava uslove za registraciju iz člana 6. ovog Zakona, ima pravo da se odluči za registraciju i o tome obavesti Administraciju .</p> <p>2. Administracija registruje takvo lice od dana prijema zahteva, ako lice koje je podnelo prijavu ispunjava uslove iz člana 4 ovog Zakona.</p> <p>3. Registrovani poreski obveznici dobrovoljno podležu istim pravilima za promenu i prestanak aktivnosti kao oporezive osobe registrovane u skladu sa članom 6. ovog Zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Çregjistrimi</p> <p>1. Çdo person i tatueshëm i regjistruar, mund të kërkojë nga Administrata, çregjistrimin e tij nga TVSH, nëse furnizimet totale gjatë vitit të fundit kalendarik kanë qenë nën pragun e referuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Deregistration</p> <p>1. Any registered taxable, may request from the administration his/her VAT deregistration, if his/her total supplies over the last calendar year have fallen below the threshold referred to in Article 6 of this</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Odjava</p> <p>1.Svako registrovano oporezivo lice može zatražiti od Administracija njegovu odjavu od PDV-a, ako je ukupna potrošnja u toku poslednje kalendarske godine bila ispod praga iz člana 6. ovog Zakona. Odjava od</p>

<p>në nenin 6 të këtij ligji. Çregjistrimi hyn në fuqi dy (2) muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës.</p> <p>2. Personat e tatueshëm nuk mund të çregjistrohen nga TVSH së paku edhe një (1) vit kalendarik të plotë pas vitit të regjistrimit.</p> <p>3. Çdo person i tatueshëm i regjistruar, është i obliguar që të kërkojë çregjistrimin nga momenti i pushimit të aktivitetit të tij. Ai duhet të njoftojë Administrata brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga momenti i pushimit të aktivitetit. Çregjistrimi hyn në fuqi duke filluar prej datës së pushimit të aktivitetit.</p> <p>4. Administrata mund të bëjë çregjistrimin e personit të tatueshëm të regjistruar për qëllime të TVSH- së, kur personi i tillë nuk i përmbushë dispozitat e këtij ligji. Administrata duhet ta njoftoj personin me vendimin dhe të ofrojë arsyet në lidhje me vendimin.</p> <p>5. Ministri nxjerr akt nënligjor për të përcaktuar procedurat në lidhje me zbatimin e neneve 7, 8 dhe 9 të këtij ligji. Ky akt nën-ligjor gjithashtu duhet të parasheh rregullat e veçanta të llogaritjes</p>	<p>Law. Deregistration enters into force two (2) months after the date of filing request</p> <p>2. Taxable persons cannot be deregistered from VAT at least one (1) full calendar year following the year of deregistration.</p> <p>3. Any registered taxable person, is obliged to require deregistration from the event of cease of its activity. He should inform the Administration within fifteen (15) days of ceasing- the activity. Deregistration enters into force following the date of ceasing-activity.</p> <p>4. The Administration may perform deregistration of a registered taxable person for VAT purposes where such person fails to comply with the provisions of the present Law. The Administration shall notify the person regarding the decision and provide the reasons for the decision.</p> <p>5. The Minister shall issue a sub-legal act determining the procedures in respect of the implementation of the Articles 7, 8 and 9 of this Law. Such sub-legal act shall provide for specific threshold calculation</p>	<p>PDV-a stupa na snagu dva (2) meseca nakon datuma podnošenja zahtevaa.</p> <p>2. Oporezive osobe ne mogu se odjaviti od PDV-a najmanje pre jedne (1) kalendarske godine nakon godine registracije.</p> <p>3.Svaki registrovani poreski obveznik je obavezan zahtevati odjavu od trenutka prekida aktivnosti. On mora obavestiti Administraciju u roku od petnaest (15) dana od trenutka prestanka aktivnosti. Odjava stupa na snagu danom prestanka aktivnosti.</p> <p>4.Administracija može izvršiti odjavu poreskog obveznika u smislu PDV-a, kada to lice ne pridržava odredbama ovog Zakona. Administracija mora obavestiti lice sa odlukom i navesti razloge za odluku.</p> <p>5. Ministar donosi podzakonski akt kojim se utvrđuju postupci vezani za primenu članova 7, 8 i 9 ovog Zakona. Ovaj podzakonski akt takođe treba da predvidi posebna pravila za izračunavanje praga za</p>
---	--	---

<p>së pragut për kategoritë e personave, qarkullimi i të cilëve në pjesën më të madhe dërmuese përbëhet nga furnizimet e liruara.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III TRANSAKSIONET E TATUESHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Furnizimi i mallrave</p> <p>1. Furnizimi i mallrave nënkupton transferin e të drejtës për të disponuar me pasuri materiale si pronar.</p> <p>2. Përveç transaksioneve që i referohen paragrafit 1 të këtij neni, secila nga këto si në vijim duhet të konsiderohet si furnizim i mallrave:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Transferi i pronësisë së pasurisë kundrejt pagesës së kompensimit:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.1. me urdhrin e bërë nga autoriteti publik;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.2. në emër të autoritetit publik, ose;</p>	<p>rules for categories of persons whose turnover to a large extent is composed of exempted supplies.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III TAXABLE TRANSACTIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Supply with goods</p> <p>1. Supply with goods shall mean a transfer of the right of having tangible property as owner.</p> <p>2. In addition to the transaction referred to in paragraph 1 of this Article, each of the following shall be regarded as a supply with goods :</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. A transfer of the ownership of property against payment of compensation :</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.1. under an order made by a Public Authority;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.2. on behalf a Public Authority, or;</p>	<p>kategorije lica čiji se promet uglavnom sastoji od izuzetih snabdevanja.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III OPOREZIVE TRANSAKCIJE</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Snabdevanje roba</p> <p>1. Snabdevanje roba znači prenos prava raspolaganja imovinom kao vlasnik.</p> <p>2. Pored transakcija koje se odnose na stav 1. ovog člana, svaka od ovih, kao u nastavku, treba se smatrati kao snabdevanje robe:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Prenos vlasništva imovine naspram plaćanja nadoknade:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.1.uz izdat nalog od strane javnog organa;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.2. u ime javnog organa, ili;</p>
--	---	---

<p>2.1.3. bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi.</p> <p>2.2. Dorëzimi aktual i mallrave sipas kontratës për qira për një periudhë të caktuar, ose për shitjen e mallrave me kushtet e shtyrjes, e cila e parasheh që në kushtet normale të rasteve pronësia duhet të kalojë më së voni me pagesën e kështit të fundit. Ministri nxjerrë akt nënligjor për procedurat e aplikimit të këtij nën-paragrafi.</p> <p>2.3. Transferi i mallrave sipas kontratës, nën të cilën duhet të paguhet provizioni në blerje apo shitje.</p> <p>3. Furnizimet e përziera:</p> <p>3.1. Furnizimi i shërbimeve i përfshirë në furnizimin e mallrave, është pjesë e furnizimit të mallrave.</p> <p>3.2. Furnizimi i shërbimeve i përfshirë në importin e mallrave, është pjesë e importit të mallrave.</p> <p>4. Dorëzimi i punëve të caktuara të ndërtimit si furnizim i mallrave rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>2.1.3. pursuant to the provisions of the applicable legislation.</p> <p>2.2. the actual handing over of goods pursuant to a leasing contract for a certain period or for selling goods on deferred terms, which foresees that ownership is at the latest transferred, in normal conditions of events, when final instalment is paid. The Minister shall issue a sub-legal act covering the procedures for applying this subparagraph.</p> <p>2.3. the transfer of goods pursuant to a contract under which commission is payable on purchase or sale.</p> <p>3. Mixed supplies:</p> <p>3.1. supply with services including the supply with goods shall be part of supply with goods.</p> <p>3.2. supply with services included in the import of goods shall be part of the import of goods.</p> <p>4. Handing over of certain construction works as a supply with goods shall be</p>	<p>2.1.3. na osnovu odredbi Zakona na snazi.</p> <p>2.2. Aktuelna predaja robe u skladu sa ugovorom o zakupu na određeno vreme ili za prodaju robe pod uslovima odlaganja, koji predviđa da u normalnim uslovima slučaja, vlasništvo treba da se prenosi najkasnije nakon uplate poslednje rate. Ministar donosi podzakonski akt za postupak primene ovog podstava.</p> <p>2.3. Prenos robe po ugovoru pod kojim treba platiti kupovinu ili prodaju.</p> <p>3. Mešana snabdevanja:</p> <p>3.1. Snabdevanje usluga obuhvaćeno u nabavku robe je deo snabdevanja robe.</p> <p>3.2. Snabdevanje usluga obuhvaćenih u uvoz robe je deo uvoza roba.</p> <p>4. Predaja odredjenih gradjevinskih poslova kao snabdevanje robe regulisane je</p>
--	---	--

<p>5. Për qëllim të këtij ligji, si pasuri materiale trajtohen kategoritë si në vijim:</p> <p>5.1. energjia elektrike, gazi, ngrohja, ftohja dhe të ngjashme;</p> <p>5.2. të drejtat in rem që i janë dhënë mbajtësit, të drejtën e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme dhe aksioneve në lidhje me pasurinë e paluajtshme i cili i jep këtij mbajtësi të drejtën e pronësisë ose posedimit të pasurisë së paluajtshme apo një pjese të saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Aplikimi i mallrave të biznesit për nevoja jo-biznesore</p> <p>1. Shfrytëzimi i mallrave nga personi i tatueshëm që janë pjesë e mjeteve të biznesit të tij, për shfrytëzim privat ose për personelin e tij apo disponimi me to i lirë nga ngarkimi ose në përgjithësi shfrytëzimi i tyre për nevoja të tjera nga ato të biznesit, duhet të trajtohet si furnizim i mallrave për konsideratë, ku TVSH është plotësisht ose pjesërisht e zbritshme në këto mallra apo në pjesët e tyre përbërëse.</p>	<p>regulated in a sublegal act issued by the Minister.</p> <p>5. For the purposes of this Law, the following categories shall be treated as material property:</p> <p>5.1. electricity, gas, heating, cooling and similar;</p> <p>5.2. in rem rights given to the holder, a right of using immovable property and shares or interests equivalent to shares in respect to immovable property which gives the holder a right of ownership or possession over immovable property or a part of it.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Applying business goods for non-business needs</p> <p>1. Using goods by a taxable person, part of his business assets for private use or for his staff, or their disposal free of charge or, more generally, their use for purposes other than those of the business, shall be treated as a supply of goods for consideration, where the VAT on those goods or the component parts thereof is fully or partly deductible.</p>	<p>podzakonskim aktim donetih od strane ministra.</p> <p>5. U smislu ovog Zakona, sledeće kao materijalne imovina tretiraju se sledeće kategorije :</p> <p>5.1. struja, gas, grejanje, hlađenje i slično;</p> <p>5.2. prava koja se daju nosiocu prava korišćenja nepokretnosti i akcije u pogledu nepokretne imovine koja daju nosiocu pravo na vlasništvo ili raspolaganje nepokretnosti ili njenog dela.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Primena poslovnih roba za ne-poslovne potrebe</p> <p>1. Korišćenje robe od poreskog obveznika koji je deo njegovih poslovnih sredstava za njegovu privatnu upotrebu ili za njegovo osoblje ili su im na raspolaganju besplatno ili, uopšte, njihova primena u druge svrhe osim onih iz njegovog subjekta, treba tretirati kao snabdevanje robe za razmatranje, gde je PDV potpuno ili delimično umanjen na ovu robu ili njene sastavne delove.</p>
---	--	---

<p>2. Shfrytëzimi i mallrave për biznes si mostra apo dhurata me vlerë të vogël, nuk duhet të trajtohet si furnizim i mallrave për konsideratë.</p> <p>3. Ministri nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>2. The use goods for business as samples or gifts of small value shall not be treated as a supply of goods for consideration.</p> <p>3. The Minister shall issue a sub-legal act to the enforcement of this Article.</p>	<p>2. Korišćenje robe za subjekat kao uzorak ili poklon sa manjom vrednošću ne treba tretirati kao snabdevanje robe za razmatranje.</p> <p>3. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Aplikimi i mallrave të biznesit për nevoja të biznesit nën rrethana të caktuara të zbritjes së TVSH-së</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Application of goods for business needs under certain VAT deduction circumstances</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Primena poslovnih roba na poslovne potrebe za popust PDV-a u određenim okolnostima</p>
<p>1. Shfrytëzimi i mallrave të prodhuara, ndërhuara, nxjerra, përpunuara, të blera ose importuara në kursin e atij biznesi, nga personi i tatueshëm për qëllime të biznesit të tij, ku TVSH në ato mallra nuk do të jetë plotësisht e zbritshme, sikur ato të ishin marrë nga personi tjetër i tatueshëm, konsiderohen si furnizime të mallrave për konsideratë.</p> <p>2. Shfrytëzimi i mallrave nga personi i tatueshëm për nevoja të aktivitetit në një fushë jo të tatueshme, ku TVSH në ato mallra bëhet plotësisht ose pjesërisht e zbritshme me përvetësimin ose shfrytëzimin e tyre në pajtueshmëri me</p>	<p>1. The use of goods produced, constructed, extracted, processed, purchased or imported in course of such business by a taxable person for the purposes of his business, where the VAT on such goods would not be fully deductible, had they been acquired from another taxable person shall be considered as a supply with goods for consideration.</p> <p>2. The use of goods by a taxable person for the purposes of a non-taxable area of activity, where the VAT on such goods becomes fully or partly deductible upon their acquisition or upon their use in line with paragraph 1 of this Article shall</p>	<p>1. Korišćenje roba proizvedenih, izgrađenih, izvađenih, preradenih, kupljenih ili uvezenih u kursu tog subjekta od poreskog obveznika u smislu njegovog subjekta, gde PDV na tu robu neće biti u potpunosti umanjena ako su uzeti od nekog drugog oporezivog lica, smatra se snabdevanje robe za razmatranje.</p> <p>2. Korišćenje robe od oporezivog lica za potrebe aktivnosti u neoporezujućom području, gde je PDV na tu robu postalo u potpunosti ili delimično umanjeno prihvatanjem ili na njihovom korišćenju u skladu sa stavom 1. ovog člana, smatraju se snabdevanje roba za razmatranje.</p>

<p>paragrafin 1 të këtij neni, konsiderohen si furnizime të mallrave për konsideratë.</p> <p>3. Me përjashtim të rasteve të referuara në nenin 13 të këtij ligji, mbajtja e mallrave nga personi i tatueshëm, ose nga pasardhësi i tij, kur ai ka pushuar së zhvilluari aktivitetin e tij ekonomik apo ka ndërprerë regjistrimin, ku TVSH në ato mallra bëhet plotësisht ose pjesërisht e zbritshme me përvetësimin e tyre ose me shfrytëzimin e tyre në pajtueshmëri me paragrafin 1 të këtij neni, gjithashtu konsiderohen si furnizime të mallrave për konsideratë.</p>	<p>considered as a supply with goods for consideration.</p> <p>3. With the exception of the cases referred to in Article 13 of this Law, the retention of goods by a taxable person, or by his successors, when he ceases to carry out a taxable economic activity, where the VAT on such goods becomes fully or partly deductible upon their acquisition or upon their use in line with paragraph 1 of this Article shall also considered as a supply with goods for consideration.</p>	<p>3. Sa izuzetkom slučajeva iz člana 13. ovog Zakona, držanje robe od strane oporezivog lica, ili od njegovog sledbenika, kada je on prestao da obavlja privrednu aktivnost ili prestanak registracije, gde je PDV na tu robu postao u potpunosti ili delimično umanjen prihvatanjem ili na njihovog korišćenja u skladu sa stavom 1. ovog člana smatra se kao snabdevanje robe za razmatranje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Transferi i biznesit</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Transfer of Business</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Prenos subjekta</p>
<p>1. Në momentin e transferit nga personi i tatueshëm qoftë për konsideratë ose jo për konsideratë, apo si kontribut për kompaninë me të gjitha mjetet ose një pjesë të tyre, nuk ka furnizim të mallrave.</p> <p>2. Personi, të cilit i transferohen mjetet, duhet të trajtohet si pasardhës i transferuesit në lidhje me mjetet e transferuara dhe nuk duhet të ngarkohet me TVSH në atë transfer, me kusht që pasardhësi i transferuesit është person i tatueshëm, i cili është i regjistruar ose është</p>	<p>1. No supply with goods shall take place in the event of a transfer by a taxable person whether for consideration or not or as a contribution to a company, with total or part of assets.</p> <p>2. A person to whom the goods are transferred shall be treated as a successor to the transferor and no VAT shall be charged on such transfer provided that the successor to the transferor is a taxable person who is registered or required to register for VAT purposes. The transferor</p>	<p>1. U trenutku prenosa sa oporezivog lica, bilo, bilo da se uzima u obzir ili ne, ili kao doprinos za odruženje svim sredstvima ili njegovim delom, nema snabdevanje robe.</p> <p>2. Lice kome se prenosi imovina se tretira kao naslednik preneoca u odnosu na prenesenu imovinu i neće biti pod teretom PDV-a po tom prenosu, pod uslovom da je naslednik preneoca oprezivo licekoje je registrovano ili je dužan da se registruje za PDV. Prenosilac i onaj koji prihvata prenos</p>

<p>i obliguar të regjistrohet për TVSH. Transferuesi dhe ai që pranon transferin, duhet të njoftojnë Administratën për qëllimin e tyre për zbatimin e këtij neni së paku tridhjetë (30) ditë para se të ndodhë transferi.</p> <p>3. Çdo obligim i pa paguar dhe e drejtë e transferuesit në lidhje me mjetet e transferuara i paraparë me anën e këtij ligji para kohës së transferit, bëhet detyrim dhe e drejtë e pranuesit të transferit.</p> <p>4. Ministri nxjerr akt nënligjor për rregullimin e procedurave dhe rregullave për aplikimin e këtij neni.</p>	<p>and the transferee shall notify the administration of their intention to implement this Article at least thirty (30) days before the transfer occurs.</p> <p>3. Any outstanding liability and outstanding right of the transferor provided by, or by virtue of this law before the time of the transfer shall become a liability and right of the transferee.</p> <p>4. The Minister shall issue a sub-legal act on regulating the procedures and rules for applying this Article.</p>	<p>mora obavestiti Administraciju o njihovoj nameri za primeni ovog člana najmanje trideset (30) dana pre prenosa.</p> <p>3. Svaka neizmirena obaveza i pravo preneoca u vezi sa prenetm sredstvima predviđenim ovim zakonom pre datuma prenosa postaju obaveza i pravo preneoca.</p> <p>4. Ministar donosi podzakonski akt kojim se uređuju procedure i pravila za primenu ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Furnizimi i shërbimeve</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Supply with services</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Snabdevanje uslugama</p>
<p>1. Furnizimi i shërbimeve nënkupton çdo transaksion i cili nuk e përbën furnizimin e mallrave.</p> <p>2. Furnizimi i shërbimeve, në mes tjerash, mund të përbëhet prej njërit nga transaksionet si në vijim:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. dhënia e pasurisë jo materiale, pavarësisht se a i nënshtrohet dokumentit të krijimit të titullit të pronësisë;</p>	<p>1. Supply with services is any transaction which does not constitute a supply with goods.</p> <p>2. A supply with services may consist, inter alia, in one of the following transactions:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. assigning intangible property, whether or not they are subject to a document establishing title of ownership;</p>	<p>1. Snabdevanje uslugama podrazumeva svaku transakciju koja ne predstavlja snabdevanje robe.</p> <p>2. Snabdevanje usluga, između ostalog, može se sastojati od jedne od sledećih transakcija:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. davanje nematerijalne imovine, bez obzira da li je predmet dokumenta o stvaranju imovine;</p>

<p>2.2. obligimi që të përmbahet nga një veprim ose të tolerohet një veprim apo situatë;</p> <p>2.3. kryerja e shërbimeve në varësi:</p> <p>2.3.1. me urdhrin e bërë nga autoriteti publik;</p> <p>2.3.2. në emër të autoritetit publik, ose;</p> <p>2.3.3. bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi.</p> <p>3. Furnizimi me shërbime të kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave dhe dheut për një kundër- shpërblim nga ana e organeve komunale ose publike.</p> <p>4. Furnizimi i mallrave i përfshirë në furnizimin e shërbimeve, është pjesë e furnizimit të shërbimeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Shfrytëzimi i mallrave dhe shërbimeve të biznesit për nevoja jo-biznesore</p> <p>1. Shfrytëzimi i mallrave që janë pjesë e mjeteve të biznesit, nga personi i</p>	<p>2.2. the obligation to refrain from an act or tolerate an act or situation;</p> <p>2.3. carrying out services in dependence to:</p> <p>2.3.1. an order given by a Public Authority;</p> <p>2.3.2. on behalf of a Public Authority, or;</p> <p>2.3.3. pursuant to provisions of the applicable legislation.</p> <p>3. The supply with services for sewage, waste collection and soil for an in return (remuneration) by the municipal and public bodies.</p> <p>4. The supply with goods included in supply with services shall be part of supply with services.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Use of business goods and services for non-business needs</p> <p>1. Using goods part of the business' assets for a private use or for his staff by a taxable</p>	<p>2.2. obaveza da se suzdrži od postupka ili da toleriše akciju ili situaciju;</p> <p>2.3. snabdevanje od zavisnosti:</p> <p>2.3.1. uz nalog izdat od strane javnog organa;</p> <p>2.3.2. u ime javnog organa, ili;</p> <p>2.3.3. na osnovu odredbi važećeg Zakona.</p> <p>3. Snabdevanje uslugama prikupljanja otpada , otpada i zemljišta za protiv- uslugu od strane opštinskih ili javnih organa.</p> <p>4. Snabdevanje roba obuhvatajući i pružanje usluga, je deo pružanja usluga.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Korišćenje poslovnih proizvoda i usluga za ne-poslovne potrebe</p> <p>1. Korišćenje roba koja su deo poslovne imovine od strane oporezivog lica ili njegovog osoblja za ličnu upotrebu ili</p>
--	---	---

<p>tatueshëm apo personeli i tij për shfrytëzim personal, ose në përgjithësi për nevoja të tjera nga ato të biznesit të tij, ku TVSH në ato mallra ka qenë plotësisht ose pjesërisht e zbritshme, duhet të trajtohet si furnizim për konsideratë.</p> <p>2. Furnizimi i shërbimeve i bërë pa konsideratë nga personi i tatueshëm për shfrytëzim të tij personal ose për personelin e tij dhe në përgjithësi për nevoja tjera nga ato të biznesit të tij, duhet të trajtohet si furnizim për konsideratë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Shfrytëzimi i shërbimeve për vetë-furnizim për nevoja të biznesit</p> <p>1. Furnizimi i shërbimit nga personi i tatueshëm për nevoja të biznesit të tij, sikur të jetë furnizuar nga një person tjetër i tatueshëm ku TVSH në atë shërbim nuk do të jetë plotësisht e zbritshme, duhet të konsiderohet si furnizim i shërbimit për konsideratë.</p> <p>2. Puna ndërtimore, e riparimit lidhur me pronën e paluajtshme të shfrytëzuar ose që do të shfrytëzohet për aktivitetin ekonomik ekzistues apo të ardhshëm dhe të bërë falas nga personi i tatueshëm ose personeli i tij</p>	<p>person or more generally, for purposes other than those of his business, where the VAT on such goods is fully or partly deductible, shall be treated as a supply for consideration.</p> <p>2. The supply of services without consideration carried out by a taxable person for his private use or for his staff or, more generally, for purposes other than those of his business, shall also be treated as a supply for consideration.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 The use of self-supplied services for business needs</p> <p>1. Supply of a service by a taxable person for purposes of his business, where the VAT on such a service if supplied by another taxable person would not be fully deductible shall be considered as a supply of a service for consideration.</p> <p>2. Construction repair work with respect of immovable property used or to be used for existing or future economic activity and rendered for free by a taxable person or its staff to itself shall be treated as a supply of services for consideration.</p>	<p>uopšte za druge svrhe osim onih iz njegovog subjekta, kada je PDV na tu robu u potpunosti ili delimično umanjen, treba tretirati kao ponudu za razmatranje.</p> <p>2. Snabdevanje usluga koje, bez obzira na oporezivo lice, za ličnu upotrebu ili njegovo osoblje i uopšte za druge namene, osim onih koje se bave njegovim poslom, tretiraju se kao ponuda za razmatranje.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Korišćenje usluga samo-snaddevanje za poslovne potrebe</p> <p>1. Dostavljanje snabdevanje od strane oporezivog lica u civilju svog subjekta, kao da je snabdeveno drugo oporezivo lice, ukoliko PDV na toj službi nije u potpunosti umanjen, smatraće se kao snabdevanje snabdevanje za razmatranje.</p> <p>2. Građevinski radovi, , renoviranja koja se odnose na nepokretnu imovinu koja se koristi ili će se koristiti za postojeću ili buduću privrednu aktivnost i koju će bezplatno uraditi od strane poreskog lica ili</p>
---	--	--

<p>për vetveten, duhet të trajtohet si furnizim i shërbimeve për konsideratë.</p> <p>3. Ministri nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Shërbimet në lidhje me transferin e biznesit</p> <p>Për furnizimet e shërbimeve në lidhje me transferin e biznesit duhet të zbatohen dispozitat e nenit 13 të këtij ligji, duke zëvendësuar furnizimin e mallrave me furnizimin e shërbimeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Furnizimi i shërbimeve në emrin e tij, mirëpo, në llogari të personit tjetër</p> <p>Kur personi i tatueshëm duke vepruar në emrin e tij, mirëpo, në llogarinë e personit tjetër, merr pjesë në furnizimin e shërbimeve, duhet që t'i pranojë dhe t'i furnizojë vetë këto shërbime.</p>	<p>3. The Minister shall issue a sub-legal act for enforcement of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Services regarding the transfer of business</p> <p>The provisions of Article 13 of this Law shall also apply to the supply with services regarding transfer of business by replacing supply of goods with supply of services.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 The supply with services in his/her own name but on behalf of another person</p> <p>Where a taxable person acting in his/her own name but on behalf of another person, takes part in supplying services, he should receive and supply these services by himself.</p>	<p>njegovog osoblja za sebe tretirati kao snabdevanje usluga za razmatranje .</p> <p>3. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Snabdevanje sa prenosom subjekta</p> <p>Za snabdevanje usluga u vezi sa prenosom subjekta primenjuju se odredbe člana 13. ovog Zakona, zamenjujući nabavku roba sa ponudom usluga.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Snabdevanje usluga u njegovo ime, ali, na račun druge osobe</p> <p>Kada poreski obveznik, postupajući u njegovo ime ali na račun drugog lica, učestvuje u pružanju usluga, mora priiti i isporučiti sam te snabdevanje.</p>
--	--	---

<p align="center">KAPITULLI IV VENDI I TRANSAKSIONEVE TË TATUESHME</p>	<p align="center">CHAPTER IV VENUE OF TAXABLE TRANSACTIONS</p>	<p align="center">POGLAVLJE IV MESTO OPOREZUJUĆIH TRANSAKCIJA</p>
